

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME MBI METODOLOGJINË E ARSIMIMIT MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Arsimimi i të drejtave të njeriut është mësimi që zhvillon njohuritë, aftësitë dhe vlerat e të drejtave të njeriut. E mbron përgjegjësinë e të dy palëve shtetit dhe individit të respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e të gjitha qenieve njerëzore pa dallim race, gjinie, moshe, përkatësie etnike dhe prejardhje nacionale apo religjioni.

Aktivitetet e radhitura në të gjitha modulet e manualeve u ndihmojnë nxënësve ta zhvillojnë kuptimin për principet themelore për të drejtat e njeriut, aftësitë komunikuese, aftësitë krijuese dhe bindëse, që të gjitha esenciale për një demokraci. Ata ofrojnë perspektiva multi-kulturore, socio-ekonomike dhe historike në luftën e përgjithshme për drejtësi dhe dinjitet. Ata janë paraparë gjithashtu të ndërlihdin zemrën dhe mendjen dhe t'i sfidojnë nxënësit e ndryshëm që ta kuptojnë se çfarë do kuptimi kanë të drejtat e njeriut personalisht për ta, dhe t'i inkurajojnë ata ta shndërrojnë kuptimin në veprim të informuar, jo të dhunshëm. Së fundi nuk duhet t'i zvogëlojmë aktivitetet që kanë për qëllim t'i kontrollojnë çështjet e të drejtave të njeriut në gjithë kompleksitetin e tyre, pa paragjykime dhe nga këndvështrime të ndryshme nëpërmjet praktikave të shumëllojshme arsimuese. Prandaj, qëllimi përfundimtar i të gjitha veprimtarive është të tregojë që secili mund të bëjë ndryshime dhe t'i kontribuojë përmbushjes së të drejtave të njeriut, drejtësisë, dhe dinjitetit për të gjithë.

Aktivitet e zgjedhura në këtë udhëzues janë diskutimet, rastet për studim, rolet dramatike, dhe, si alternativë, ka aktivitete të lira. Hollësitë kryesore të çdo metode janë të përshkruara më poshtë dhe janë të përcjella nga informata të tjera mbi metodën e cila do t'i ndihmojë moderatorit që të zhvillojë një qasje kreative dhe inovatore për probleme komplekse të cilat prezantohen në çdo aktivitet.

MEDITIMI NË GRUPE

Meditimi në grupe nxit kreativitetin dhe lindjen e shpejtë të shumë ideve. Ai mund të përdoret për të gjetur rrugë alternative për zgjidhjen e problemeve specifike, për t'u

dhënë përgjigje pyetjeve, për përfshirjen e një teme të re, ngritjen e interesit dhe bërjen e hulumtimit mbi bazat e dijes.

Një sesion i meditimit në grupe mund të marrë këto forma:

- Parashtrimin e nje pyetjeje, problemi apo teme (me gojë ose me shkrim).
- Thirrjen e anëtarëve të grupit që të përgjigjen me sa më shumë ide dhe sygjerime, teoretikisht, me një fjalë të vetme, apo në fraza të shkurtra.
- Shënimin e përgjigjeve në hamerë (mbajeni mend këtë, shumë shpesh, sygjerimet më kreative apo më fyese janë më interesante dhe të përdorshme).
- Vënia e prioriteteve, analizimi i përfundimit, dhe grumbullimi i zgjedhjeve.

Sesionet e meditimit në grupe janë vegla tejkaluëse që ndihmojnë paraqitjen e temave të ndryshme, si dhe mund të përdoren si simulime për dialog, rol apo aktivitet

DISKUTIMI

Diskutimet nxisin ndikim, analizë dhe mendim kritik. Aato ofrojnë një mësim johierarkik bashkëpunues dhe demokratik dhe ndihmojnë pjesëmarrësit që të respektojnë dhe pranojnë pikëvështrimet dhe opinionet e ndryshme. Për ta mbajtur diskutimin të përqendruar, ju ndoshta duhet t'i parashtroni disa pyetje kyçe. Sa më i madh të jetë grupi, aq më e mundshme do të jetë që disa pjesëmarrës të dominojnë në diskutime, kurse të tjerët do të rrinë të heshtur. Për të siguruar se çdonjëri e ka mundësin që të flasë, ju mund ta ndani grupin në njësi më të vogla. Kur diskutimit i afrohet përfundimit, përmblihdh pikat kryesore me gojë dhe me shkrim. Moderatorët duhet ta mbajnë mend qartë qëllimin e diskutimit; ata duhet të parashtrojnë pyetje dhe ta nxisin pjesëmarrjen dhe analizën.

- Kushtimitsh: “Çka do të bësh nëse...?”
- Duke bërë spekulime: “Si mund ta zgjidhim ne problemin?”
- Duke definuar: “A mund të na thoni se si mendoni që ideja juaj do të funksionojë?”
- Duke provuar: “Pse e mendoni ashtu?”
- Qartësim / Përmbledhje: ”A kam të drejtë të them “ti mendon”...?”

Një mënyrë për të ndihmuar që të krijohet ambienti i besimit dhe i respektit të ndërsjellë është që t'i bëjmë pjesëmarrësit t'i zhvillojnë “rregullat e tyre të diskutimit”:

- Kërko nga ata që të mendojnë për disa parime për diskutim, të cilat mendojnë që çdonjëri do t'i ndjekë.
- Shkruaji të gjitha sygjerimet në një vend ku mund t'i shohin ata, duke kombinuar dhe thjeshtësuar kur është e nevojshme. Nëse rregullat e mëposhtme nuk janë të sygjeruara, përfshiji ato të cilat mendon se janë absolutisht të nevojshme për diskutim
 - Dëgjo personin që po flet!
 - Vetëm një person flet në të njëjtën kohë!
 - Merr pajtimin për një shenjë të veçantë që të njoftohesh nëse doni të thoni diçka!
 - Shmangiu ndërhyrjes, kur ndonjëri është duke folur!
 - Kur nuk pajtoheni me dikë, sigurohu që je duke bërë dallim në mes të kritikës ndaj idesë së dikujt dhe kritikës ndaj personit!
 - Mos qeshni kur dikush flet – vetëm në qoftë se ai bën shaka!
 - Inkurajoje çdonjërin që të marrë pjesë!

Së fundi, ju duhet të kopjoni listën e rregullave dhe ta varni në vende ku të gjithë mund ta shohin, shto apo bëj ndryshime nëse është e nevojshme.

RASTET PËR STUDIM

Rastet mund të inkurajojnë analizën, mendimin kritik, zgjidhjen e problemit dhe të aftësive planifikuese, si dhe bashkëpunimin dhe ndërtimin e ekipeve. Ato mund të përdoren që të ndërtojnë debate efektive (p.sh. grupet me detyrë që të debatojnë për pozicione të caktuara të një rasti). Rasti që mund ta zgjidhni mund të jetë një:

- rast real, i nxjerrë nga ngjarjet e tanishme apo historike;

- rast i imagjinuar apo hipotetik që adreson një çështje të veçantë apo tema të praktikumeve. Rastet imagjinare shumë shpesh mund të adresojnë çështje të rëndësishme lokale, pa provokuar përgjigje për individë të veçantë, organizata, grupe sociale apo rajone gjeografike;
- rasti i jashtëm i cili mund t'i orientojë pjesëmarrësit që të punojnë dhe të reagojnë përbrenda bashkësisë së tyre

Akti dramatik

Në aktin dramatik, pjesëmarrësit vendosen në rrethana imagjinare. Moderatorët ose mund të ofrojnë një rol dramatik të detajuar, ose apo duhet të japin vetëm pak informata dhe t'i lejojë pjesëmarrësit që ta zhvillojnë vetë. Aktorët në aktin dramatik mund të shtiren se janë dikush tjetër apo mund të aktrojnë si ata vetë në një situatë të re. Sidoqoftë, është e nevojshme të bëhet e qartë në fillim se akti dramatik nuk duhet të jetë shumë i gjatë apo shumë i detajuar që shikuese, si dhe aktorëve t'u krijohet mundësia që t'i ndjekin ata lehtë. Shumë shpesh aktet dramatike kanë një fund të hapur në mënyrë që të arrijnë qëllimet mësimore dhe të simulojnë diskutimin. Mirëpo, pyetjet e kujdesshme në fund, janë esenciale që t'u mundësohet pjesëmarrësve që t'i tërheqin paralelet në mes asaj që ata kanë përjetuar në situata të ndryshme në botën reale. Moderatorët nuk duhet të jenë shumë të ndieshëm për faktin që disa njerëz mund të ndihen parehatshëm, mundimshëm apo edhe të pafuqishëm në situatat e caktuara.

HYRJA / NGROHJA

Të fillosh një aktivitet së pari duhet t'i njoftosh ndërmjet vete dhe të mundohesh që ata të ndihen të mirëseardhur. Nëse është e nevojshme, përdore të ashtuquajturën “akullthyerje” një aktivitet që i ndihmon pjesëmarrësit që të mësojnë më shumë për njëri-tjetrin dhe të jenë të rehatshëm që të shprehen në grup.

AKULLTHYESIT:

- **Grupi Jetëdrejtë:** çdo person sjell ndonjë objekt me kuptim nga shtëpia, që të kontribuojë për një ekspozitë të hapur si një mënyrë që të paraqesin diçka me rëndësi për vetveten.
- **Radhitni në vijë të drejtë:** Lejoni që të radhiten sipas gjatësisë, moshës, muajit të lindjes, madhësisë së këmbës e kështu me radhë.
- **Intervistat:** Çdo person bëhet çift me një tjetër dhe parashtro disa pyetje. Pastaj çdo partner e njeh tjetrin me të gjithë grupin.
- **Edhe Unë!** Një person thotë emrin e tij apo të saj dhe fillon të flasë për vetveten. Sapo dikush nga dëgjuesit dëgjon që ka diçka të përbashkët me folësin, ndërhyr duke thënë emrin e tij, dhe duke filluar të tregojnë diçka për vetveten. Vazhdo që çdonjëri në grup të prezantohet.
- **Karriget muzikore:** Rregulloji karriget si një rreth i mbyllur dhe kërko nga pjesëmarrësit që të ulen. Qëndro në mes të rrethit dhe thuaje emrin dhe diçka për vetveten. Kur e bën këtë, duhet ta ndërrosh karrigen me atë që ka diçka të përbashkët me ty (p.sh. Unë jam X dhe unë i kam dy fëmijë; unë jam X dhe unë nuk i dua minjtë....) Mundohu që të sigurosh një karrige për veten. Personi i cili mbetet pa karrige prezenton vetveten dhe thotë diçka (si në shembullin e mësipërm) që mund të ketë sërish të përbashkëta me të tjerët.
- **Nyjet:** U thoni të gjithëve që të bëhe shpinë për shpine në rreth dhe me duar të drejtë përballë. Tash duhet të kapin duart në rreth. Askush nuk mund t'i mbajë duart anash. Tash, u thoni pjesëmarrësve që të zgjidhin nyjën pa i lëshuar duart.

Pasi që pjesëmarrësit njoftohen me njëri-tjetrin, moderatorët duhet t'i vënë në pah disa gjëra për grupin, në mënyrë që të nxjerrë maksimumin nga aktiviteti:

- Paraqit orarin e këtij aktiviteti dhe qëllimin tënd që të respektosh kohën e pjesëmarrësve, duke filluar dhe përfunduar me saktësi. Madje ju mundi ta lutni dikë që të shërbejë si një kohëmatës, në veçanti për aktivitetet e grupeve të vogla.
- Shpjego sferën e aktivitetit dhe kërko nga pjesëmarrësit që të thonë se çka presin; shkruaji këto në hamer. Pastaj, shqyrto listën dhe vlerëso hapur nëse ky sesion mund t'i plotësoj pritjet e shkruara.

- Kërko nga grupi se çka nuk duan dhe shënoje edhe këtë. Kjo ofron një bazë të mirë për vendosjen e rregullave themelore për grupin.
- Së bashku me grupin vër rregullat themelore të cilat do të ndihmojnë që të ofrosh një ambient të besueshëm dhe të bëjnë ndërveprimin e respektuar, të besuar dhe me vlerë.

Dhënia e vlerësimeve

Dhënia e vlerësimeve është një pjesë qenësore e aktivitetit si tërësi. Ka mënyra të ndryshme që të merret vlerësimi dhe t'i pajisësh pjesëmarrësit me të, pra moderatorët duhet t'ia bëjnë vetes këto pyetje:

- Si ndihen njerëzit për këtë aktivitet?
- Çka ishte më pak e vështirë sesa që e kishin menduar?
- Cilat ishin aspektet më të vështira të tij, apo gjërat më të vështira për paraqitje?
- A kanë mësuar njerëzit ndonjë gjë për të drejtat e njeriut?
- Ku janë ngjashmëritë apo dallimet në mes grupit(eve)?
- A kishtë ndonjë mospajtim themelor mbi idenë e të drejtave të njeriut? Pse?

Pas dhënies së vlerësimeve, është me rëndësi që të respektohen të tjerët, të fokusoheni në çka thojnë apo çka bëjnë, dhe të japësh arsye për mendimin tënd.

Disa mënyra për dhënien e vlerësimit:

- **Kutia e votimit:** Çdo pjesëmarrës e shkruan mendimin e tij për aktivitetin në një copë të letrës dhe e vendos në kuti. Pastaj çdonjëri e merr njërën nga letrat dhe e lexon me zë, ndërsa i gjithë grupi flet për mendimin e shkruar në atë letër.
- **Vazhdo, unë po dëgjoj:** Çdo person ka 5 minuta që t'i tregojë dëgjuesit të tij/saj mendimin personal për aktivitetin.
- **Makina e njerëzve:** Të gjithë pjesëmarrësit formojnë një rreth, duke u kapur për dore, dhe pastaj një person fillon të thotë diçka që atij/asaj nuk i ka pëlqyer. Personi përballë tij/saj përsërit këtë mendim, pajtohet ose nuk pajtohet me të dhe jep një mendim për diçka tjetër.

- **Raporti i motit:** Pjesëmarrësit përshkruajnë se si ndihen për aktivitetin, sikurse të ishin në raport për motin.

PËRFUNDIMTARE

Është me rëndësi që të kryhet ky aktivitet me një thënie me vend. Në veçanti, pjesëmarrësit kanë nevojë t'u jepet mundësia që t'i përmbledhin ato që kanë mësuar, në mënyrë individuale apo si kolektivitet. Në përgjithësi, mënyra se si përfundohet varet nga qëllimet dhe rrjedha e aktivitetit. Këtu kemi disa ide:

- **Hedhja e topit:** Pjesëmarrësit ia hedhin topin njëri-tjetrit. Çdo person i cili e kap topin thotë diçka që ai/ajo e ka mësuar apo mund ta përdorë nga ky sesion.
- **Përmbledhje kolektive:** Parashtro një pyetje përmbledhëse (cilat thënie që i keni dëgjuar sot këtu, ju do t'i kujtoni në veçanti si domethënëse!?) apo një fjalë mbyllëse (mundohuni të mendoni një fjalë apo frazë e cila i përmbledh të gjitha ndjenjat tuaja). Kërko nga pjesëmarrësit që të përgjigjen si duhet.
- **Prezantimi me sllajde:** moderatori ka bërë fotografi gjatë sesionit, përfshirë këtu edhe për pjesëmarrësit e tij. Si një reflektim mbi aktivitetin, çdo pjesëmarrës jep një koment të shkurtër mbi kontributin e tij/saj, ndjenjat para, gjatë, dhe pas sesionit.

PSE ADN?-

METODOLOGJIA E ADN

Arsimimi për të drejtat e njeriut është thelbësor për qytetarët aktivë në një shoqëri pluraliste dhe demokratike. Qytetarëve duhet t'u bëhet e mundur që të mendojnë në mënyrë kritike, të marrin vendime morale, të marrin qëndrime parimore për çështje, dhe që të planifikojnë kahet demokratike të veprimit. Vetëm qeniet njerëzore të cilat i kuptojnë të drejtat e njeriut mund të punojnë për sigurimin dhe mbrojtjen e tyre nga vetja e tyre dhe nga të tjerët. Por, që të jetë e mundur përfshirja kështu, është e nevojshme të jeni i informuar. Arsimimi efektiv për të drejtat e njeriut ka dy qëllime thelbësore: mësimin RRETH të drejtave të njeriut dhe mësimin PËR të drejtat e njeriut. Mësimi është

njohës i gjerë, përfshirë këtu historinë e së drejtës, dokumentet dhe mekanizmat zbatuese. Arsimiti për të drejtat e njeriut nënkupton kuptimin dhe përfshirjen e parimeve të barazisë njerëzore dhe dinjitetit, si dhe zotimit për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e të gjithë njerëzve. Nuk është e mjaftueshme ajo që dimë, por mënyra se si veprojmë.

Të drejtat e njeriut janë frymëzuese të larta por po ashtu edhe shumë praktike, duke përbashkuar shpresat dhe idealet e shumicës së qenieve njerëzore dhe po ashtu ofrimi i mundësisë për njerëzit që t'i arrijnë ato. Arsimiti mbi të drejtat e njeriut ndan këto aspekte inspiruese dhe praktike. Ai rregullon standardet, por gjithashtu shkakton ndryshime. Pra arsimimi për të drejtat e njeriut mund:

- të shkaktojë ndryshime në vlera dhe qëndrime;
- të shkaktojë ndryshime në sjellje;
- të ofrojë mundësinë për drejtësi shoqërore dhe solidaritet për çështjet, bashkësitë dhe popujt;
- të ndihmojë zhvillimin e dijes dhe aftësutë analitike;
- të inkurajojë pjesëmarrjen në arsimim.

Në këtë fushë të re janë ngritur shumë qëllime dhe përmbytjet që duhet t'i arrijnë këto qëllime gjenden nën një debat të përgjithshëm, të vazhdueshëm dhe kreativ.

Disa nga qëllimet më motivuese janë për:

- të zhvilluar analizën kritike për situatën jetësore të tij/saj;
- ndërrimin e sjelljeve;
- qartësimin e vlerave;
- zhvillimin e solidaritetit;
- analizën e situatave në kuptim të të drejtave të njeriut
- krijimin e strategjive dhe zbatimin e përgjegjeve të caktuara për padrejtësi

Udhëzuesi “Duke Kuptuar të Drejtat e Njeriut” synon t'i kontribuojë debatit të tashëm të arsimimit për të drejtat e njeriut në kuptimin të përmbytjes dhe formës, si dhe plotësimin të procesit për gdhendjen e kulturës së çiltër për të drejtat e njeriut në të gjithë botën. Synimi ynë është që t'i ndihmojmë ata që mësojnë, në mënyrë që të përfitojnë dije dhe

aftësi për të marrë kontrollin mbi jetën e tyre. Ne besojmë se duke kuptuar të drejtat e njeriut, një proces në të cilin arsimimi mbi të drejtat e njeriut ka një rol kryesor, kjo nënkupton mundësi dhe jetë më të mira për shumë njerëz. Vetëm me respektimin e parimeve të të drejtave të njeriut, jetët tona mund të parashtrajnë themelet për një bashkëjetëse dhe respektim të të drejtave të të tjerëve.

REFERENCAT:

Nancy Flowers. 2000. *Doracak mbi arsimimin e të drejtave të njeriut. Praktika efektive për mësim, veprim dhe ndërrim. Seritë e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut. Libri Temë 4.* Universiteti i Minesotës: Qendra e Burimeve për të Drejtave të Njeriut dhe Fondacioni Stanley.